

VENDIM
Nr.772, datë 24.9.2010

PËR ZBATIMIN E RREGULLORES NDËRKOMBËTARE TË SHËNDETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.10 138 datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Instituti i Shëndetit Publik është institucioni kryesor kombëtar, përgjegjës për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit (RRNSH), si dhe institucioni që raporton e informon Ministrinë e Shëndetësisë e Organizatën Botërore të Shëndetësisë për çdo ngjarje të pazakontë, të përcaktuar në rregullore.

2. Instituti i Shëndetit Publik ndjek dhe udhëheq zbatimin e detyrimeve të institucioneve, që rrjedhin nga Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit.

3. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit janë autoritetet përgjegjëse për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, brenda juridiksionit përkatës, në çdo pikë hyrje të territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe institucionet e tjera, që kanë detyrime dhe përgjegjësi në veprimtarinë e tyre, në pikat hyrëse në vend.

4. Instituti i Shëndetit Publik bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet me institucionet, që janë autoritete përgjegjëse për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit.

5. Ngarkohen të gjitha institucionet, autoritete përgjegjëse për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, që të fillojnë menjëherë dhe brenda 5 (pesë) vjetëve nga miratimi i këtij vendimi, të përfundojnë marrjen e masave për zhvillimin, forcimin dhe mbajtjen e kapaciteteve të domosdoshme për të zbuluar, vlerësuar, njoftuar e raportuar ngjarjet shëndetësore në përputhje me RRNSH-në dhe për t’u përgjigjur rreziqeve e emergjencave të shëndetit publik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha